Arjou

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË SË SHTETIT
AKADEMIA E SIGURISË

Nr.392/3 Prot. Tiranë, më 12.2.2024

# URDHËR

**Nr. 87/1, datë 12.2.2024**

**Për**

**miratimin e Kalendarit Akademik për Programin "Specialist të hetimit të krimit", viti akademik 2023 – 2024**

***Bazuar në*** nenin 29, pika 2. b të Rregullores së Policisë së Shtetit, miratuar me V.K.M nr. 750, datë 16.09.2015; urdhërin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, nr. 288, datë 05.02.2024, "Për shpalljen e rezultateve përfundimtare, si dhe fillimin e trajnimit me temë "Specialist të hetimit të krimit", për shtetasit që kanë përfunduar ciklin e dytë të studimeve të arsimit të lartë"; urdhrin e Rektorit të Akademisë së Sigurisë, nr. 87, datë 12.03.2024, "Për fillimin e trajnimit me temë "Specialist të hetimit të krimit", në Akademinë e Sigurisë, për shtetasit që kanë përfunduar ciklin e dytë të studimeve të arsimit të lartë";

***Me qëllim***, zhvillimin normal të procesit mësimor dhe gjithë aktiviteteve që kanë të bëjnë me programin e studimit "Specialist të hetimit të krimit" në Fakultetin e Sigurisë dhe Hetimit;

**URDHËROJ:**

1. Miratimin e kalendarit akademik për zhvillimin e programit të studimit "Specialist të hetimit të krimit", viti akademik 2023-2024, sipas lidhjes nr.1, pjesë e pandashme e këtij urdhri.
2. Me zbatimin e këtij urdhri, ngarkohet Fakultetit i Sigurisë dhe Hetimit, si dhe Drejtoria e Kurrikulave dhe Sigurimit të Cilësisë.
3. Për kontrollin e zbatimit të urdhrit, ngarkohet Dekani i Fakultetit të Sigurisë dhe Hetimit, si dhe Drejtori i Kurrikulave dhe Sigurimit të Cilësisë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**REKTORI**

**Prof. Ilirjan MANDRO**